

Dita e fëmijëve në Kuvendin e Shqipërisë

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, 1 qershorit, Kuvendi i Shqipërisë nëpërmjet grupit të deputetëve “Miqtë e Fëmijëve” zhvilloi në mjediset e sallës së Kuvendit të Shqipërisë aktivitetin “Dita e fëmijëve në Kuvendin e Shqipërisë”.

Në aktivitetin e zhvilluar në Kuvendin e Shqipërisë u prezantua grupi i fëmijëve “Zëri 16+...”, përfaqësues të të cilit prezantuan gjetjet dhe rekomandimet e raportit “Zëri i të Rinjve 2017, Shqipëri”, realizuar përmes Agjencisë Suedeze për Zhvillim e Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe “Save the Children”.

Në raportin e paraqitur fëmijët vunë theksin te reagimi i shërbimeve publike, duke kërkuar që institucionet qeveritare në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe të shoqërisë të mbajnë përgjegjësi për zbatimin e të drejtave të fëmijëve.

Z. Gramoz Ruçi, Kryetari i Kuvendit, njëherësh edhe Kryetar i grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, pas prezantimit të raportit nga të rinjtë e “Zëri 16+...”, mbajti një fjalë përshëndetëse për aktivitetin. Kryetari i Kuvendit, pasi uroi fëmijët për Ditën e tyre Ndërkombëtare, në hyrje të fjalimit të tij e veçoi detyrën e kryetarit të grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve” nga përgjegjësitë e tij të tjera, duke u shprehur: *“më e nderuara detyrë që kryej si përfaqësues i popullit dhe Kryetar i Kuvendit, është misioni im si Kryetar i grupit të deputetëve “Miqtë e Fëmijëve”*”